



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

RELACION

MBI MIRATIMIN E PROJEKTIT “RRUGA E RE BILÇË - DROBONIK,” DHE MIRATIMIN NË PARIM TË PROCEDURAVE TË SHPRONËSIMIT

Të nderuar Këshilltarë,

Bashkia e Beratit nisur nga nevoja për përmirësimin sa më të shpejtë dhe efikas të aksesit në shtet turistike, zhvillimit të infrastrukturës rrugore në qytet dhe mbrojtjen e eko-sistemit natyror, ka realizuar përgatitjen e projektit teknik me objekt: “**Rruga e re Bilçë - Drobonik,**” Berat.

Objektivi kryesor i këtij projekti është të sigurojë akses në zonat me potencial turistik, duke lidhur Zona ku shtrihet ky projekt I cili ndodhet në jug të qytetit të Beratit. Rruga e re fillon te Ura e fshatit Bilçë dhe lidhet me rrugën e Drobonikut rreth 2.2 km para se të arrijë në Drobonik. Rruga e re parashikohet të jetë rreth 1.7 km. Aktualisht, fshati Drobonik lidhet me qytetin e Beratit nëpërmjet rrugës Nacionale Berat-Këlcyre dhe nuk ekziston asnjë mundësi tjetër lidhjeje rrugore për tu lidhur me fshatin me të afërt, Bilçën. Fshati i Drobonikut dhe i Bilçës janë përcaktuar në broshurën turistike të bashkisë si destinacione të rëndësishme për promovimin e vlerave ekologjike, agroturistike dhe për atraksione sportive.

Për këtë arsye shihet e nevojshme lidhja e fshatit Drobonik me fshatin Bilçë dhe me qytetin e Beratit nëpërmjet një aksesit rrugor të dytë i cili do të mundësojë jo vetëm promovimin e vlerave të lartpërmendura por edhe shkurtimin e konsiderueshëm të distancës aktuale. Relievi i këtij segmenti rrugor paraqitet i komplikuar (me kondita jo të mira nga pikëpamja gjeometrike në plan dhe në lartësi e aksit të parashikuar të rrugës).

Gjurma e rrugës është e mbuluar me bimësi në pjesën më të madhe të saj, me një gjatësi rreth L=1,7km.

Qëllimi kryesor:

1. Projekti është shumë i rëndësishëm për lidhjen e Ures së Bilces me Rrugën e Ballabanit që aktualisht është duke u zbatuar I cili do të lidh edhe fshatrat e Tepelenes, Permetit me Beratin.
2. Lidhja e fshatit Drobonik dhe fshatrat përreth tij me fshatin Bilçë dhe Bypass-in e ri të qytetit nëpërmjet Ures së Re aktualisht po ndërtohet mbi lumin Osum për shkurtimin e distancës dhe kohës që i duhet banorëve të këtyre fshatrave të vijnë në qytetin e Beratit.
3. Eliminon trafikun në lagjen muzeale Gorice si zone shumë e frekuentuar nga turistët vendas dhe të huaj.

Objektivi i përgjithshëm i këtij projekti është hartimi i një Projekt Zbatimi për ndërtimin e një rruge të re lidhëse midis fshatit Drobonik dhe fshatit Bilçë (Bypass-it të ri), e cila do të mundësojë qarkullimin e mjeteve me lehtësi dhe shkurtimin ndjeshëm të distancës dhe kohës që i duhet banorëve të këtyre fshatrave të vijnë në qytetin e Beratit.



Në mënyrë që projekti të aplikohet për financim, është e nevojshme miratimi i projektit, si edhe miratimi në parim për Bashkinë Berat për të avancuar me procedurat e shpronësimit të objekteve të cilat mund të preken nga ky investim, të cilat do të identifkohen nga grupi i punës së Bashkisë Berat.

Faleminderit,

KRYETARI I BASHKISË

Ervin DEMO



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA BERAT

RELACION

PËR MIRATIMIN E TRANSFERIMIT NË PËRDORIM TË ASETEVE NGA BASHKIA

BERAT DHE AGJENSIA E SHËRBIMEVE TË BASHKISË BERAT, TEK SHA

‘BERAT CITY GREEN’ SHOQËRI AKSIONARE ME 100% TË AKSIONEVE TË

BASHKISË BERAT

Të nderuar Këshilltarë,

Në kuadër të ushtrimit të funksioneve të dhëna me ligjin 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, ligjin nr.10463 datë 22.09.2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve” i ndryshuar, Bashkia Berat ka nënshkruar kontratën e kryerjes së shërbimit të pastrimit me operatorin privat. Kjo kontratë i përfundon efektet e saj në fund të muajit prill 2024. Bazuar në studimin e pastrimit të hartuar nga grupi i punës së ngritur me urdhër të kryetarit të Bashkisë, Këshillit Bashkiak ju propozua miratimi i kryerjes së shërbimit të pastrimit nga SHA “BERAT CITY GREEN” me 100% të aksioneve të Bashkisë Berat.

Për kryerjen e shërbimit të pastrimit nga SHA “BERAT CITY GREEN” është e domosdoshme që shoqëria të këtë në përdorim të saj një pjesë të aseteve të Bashkisë Berat në funksion të këtij shërbimi. Kalimi në përdorim i aseteve është një e drejtë ligjore e këshillit bashkiak bazuar në ligjin nr.139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar, neni 9, pika 1.2, pika c, neni 54.

Asetet të cilat kërkojmë të transferohen në administrim të SHA “BERAT CITY GREEN” me 100% të aksioneve të Bashkisë Berat janë - Shesh Depozitimi i mbetjeve urbane të Bashkisë Berat me numër pasurie 1406,1365/21,1365/23, 1365/22 Zona kadastrale 1587,Fshati Dushnik, Njësia Administrative “Otlak”, i cili do të mirëmbahet nga shoqëria duke ushtruar funksionet e nevojshme në funksion të realizimit të shërbimit të pastrimit.

4

Një aset tjetër të cilin kërkohet të administrohet nga SHA "BERAT CITY GREEN" është Tregu i Gjellbërt në Rajonin nr. 1, i cili është ndërtuar në zbatim të një projekti bashkëkohor të Bashkisë Berat. Nisur nga fakti që një nga fushat e veprimtarisë së SHA "BERAT CITY GREEN" është edhe tregu i gjellbër në Rajonin nr.1 propozojmë që tregu të kalojë në administrim të plotë të kësaj shoqërie.

Asetet të cilat kërkohet të transferohen në përdorim të SHA "BERAT CITY GREEN" me 100% të aksioneve të Bashkisë Berat janë edhe Buldozer LR 634, viti i prodhimit 2005, model "Libeher LR 634" dhe Kamion IVECO Daily, viti i prodhimit 2023, kapaciteti 2998 CCM, numri i shasisë ZCFCE 70BXCO5590, targa AB 301NL. Buldozeri do të shërbejë për mirëmbajtjen e sheshdepozimit të Bashkisë Berat ndërsa Kamioni për grumbullimin e mbetjeve të riciklueshme.


Element parësor për kryerjen e shërbimit të pastrimit janë kontenierët. Për këtë arsye kontenierët për mbetjet e riciklueshme copë 1200, volumi 240 litra dhe kontenierë për mbetjet e riciklueshme, cope 120, volumi 1.1 m³ propozojmë të transferohen në përdorim SHA "BERAT CITY GREEN" e cila do të kryej shërbimin e pastrimit në qytetin e Beratit .

SHA *Berat City Green* do të jetë përgjegjëse për mirëmbajtjen dhe funksionimin e aseteve më sipër, për sa kohë i ka në përdorim.

Ju faleminderit,

KRYETARI I BASHKISË

Ervin DEMO





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA BERAT

RELACION

PËR MIRATIMIN E STUDIMIT TË MENAXHIMIT TË INTEGRUAR TË MBETJEVE TË NGURTA URBANE DHE TRANSFERIMIN E KËTIJ SHËRBIMI NË SH.A. "BERAT CITY GREEN" SHOQËRI AKSIONARE ME 100% TË AKSIONEVE TË BASHKISË BERAT

Të nderuar Këshilltarë,

Bashkia Berat aktualisht e kryen shërbimin e pastrimit prej 5 vitesh nëpërmjet kontraktuesit privat, kontratë e cila përfundon në datën 27 Prill 2024 .

Bashkia Berat ngriti grupin e punës për hartimin e studimit për "MENAXHIMIN E INTEGRUAR TË MBETJEVE TË NGURTA URBANE".

Studimi për shërbimin e pastrimit është punuar duke marrë në konsideratë përgjegjësinë për rritjen e cilësisë së shërbimit dhe shtimin në mënyrë të konsiderueshme të territorit të mbuluar me shërbim pastrimi siç janë lagjet muzeale dhe shtrati i Lumit Osum.

Studimi i mësipërm përfshin të gjithë territorin e Bashkisë Berat, të gjitha Lagjet dhe Njësitë Administrative, shërbim i cili do ofrohet në 365 ditet e vitit. Gjithashtu besojmë fort se përveç rritjes së cilësisë së shërbimit që do të kryhet nga sh.a "Berat City Green" me 100% aksione shtetërore do të bëjë të mundur një menaxhim financiar më të mirë dhe më eficient në shërbim të qytetarëve.

Shërbimi i pastrimit në Bashkinë Berat nuk do të ofrohet nga operatorë privat por ky shërbim do të kryhet nga SH.A "Berat City Green" sipas zërave më poshtë :

- 1.Grumbulimi i dhe transportimi i mbetjeve Urbane dhe tregjeve "Berat"
- 2.Grumbulimi i dhe transportimi i mbetjeve Urbane dhe tregjeve "Otlak"
3. Grumbulimi i dhe transportimi i mbetjeve Urbane dhe tregjeve "Sinjë dhe Velabisht"
4. Grumbulimi i dhe transportimi i mbetjeve Urbane dhe tregjeve "Roshnik"
- 5.Investime për kontenier te rinj
- 6.Fshirja e rrugëve dhe trotuareve me krahë
- 7.Fshirja e rrugëve me makineri teknologjike
8. Mirëmbajtje rrugësh kryesore , trotuareve dhe shesheve
- 9.Larja me presion dhe solucion të pedonales
- 10.Larja e rrugëve pasdite

11. Larja e rrugëve paradite
12. Transport i mbeturinave me krahë (karrocë dore)
13. Larja dhe disinfektimi i kontenierëve
14. Shërbimet e pastrimit ne lagjet muzeale dhe në shtratin e lumit
15. Shërbimet ne shesh dopozitim
16. Riciklimi

Kostoja e parashikuar e shërbimeve të pastrimit per 365 ditë per 16 zërat e mësipërm është në vlerë 119,049,121 lekë me TVSH.

Vetëm për vitin 2024 për periudhën 27.04.2024-31.12.2024 zëri i grumbullimit dhe transportimit të mbetjeve urbane drejt shesh depozitimit, do të kryhet nga operatorë private , procedurë e cila është ne proces e siper prokurimi .Bashkia Berat nuk mund t'a kryej këtë shërbim për këtë periudhe ,pasi jemi në pritje të mjeteve të grumbullimit dhe transportit të mbetjeve, mjete të cilat do të mundësohen brenda Dhjetorit 2024 nga "Projekti për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve Urbane në Bashkinë Berat' 'financuar nga KFW- Banka Gjermane për Zhvillim.

Për këtë periudhe sh.a "Berat City Green" do të ketë në dispozicion nje mjet buldozier për sistemimin dhe ngjeshjen ne shesh depozitim , dhe nje kamion (te dy mjetet jane te dhuruara nga donatorët per Bashkine Berat). Shërbimet të cilat do te kryej sh.a "Berat City Green" për periudhën 27.04.2024-31.12.2024 perfshijne:

1. Fshirja e rrugëve dhe trotuareve me krahë
2. Mirëmbajtje rrugësh kryesore , trotuareve dhe shesheve
3. Transport i mbeturinave me krahë (karroce dore)
4. Larja dhe disinfektimi i kontenierëve
5. Shërbimet e pastrimit ne lagjet muzeale dhe në shtratin e lumit
6. Shërbimet në shesh dopozitim
7. Riciklimi

SHA "Berat City Green" do të fillojë menjëherë kryerjen e këtyre shërbimeve pas përfundimit të kontratës aktuale ndërmjet Bashkisë Berat dhe kompanisë sipërmarrëse "ANTE Grup", kontratë e cila përfundon në 27.04.2024.

Kostoja e parashikuar e shërbimeve të pastrimit për periudhën 28 Prill- 31 Dhjetor 2024(248 dite) është në vlerë 34,244,947 lekë me TVSH.

Propozojmë :

1.Miratimin e Studimit të Menaxhimit të integruar të mbetjeve të ngurta Urbane të Bashkisë Berat.

2.Propozojmë që ofrimi i shërbimeve të parashikuara në studimin e mësipërm të kryhet nëpërmjet SH.A "Berat City Green" me aksione 100% të Bashkisë Berat.

3.Ne mënyrë qe SH.A "Berat City Green " të fillojë aktivitetin për të ofruar shërbimin e pastrimit menjëherë pas miratimit të këtij vendimi,propozojmë që Bashkia Berat ti kalojë shumën prej 10,000,000 lekësh ,fond i cili do të merret nga buxheti vjetor i programit të shërbimeve publike për shërbimin e pastrimit.

Ju faleminderit,

KRYETARI I BASHKISË

Ervin DEMO

